




REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISË
AGJENSIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
DREJTORIA RAJONALE E OFRIMIT FORMIMIT PROFESIONAL PUBLIK Fier**

Nr *200* Prot

Fier më, *09* .06 .2022

Lënda: Njoftim për Vend te lire pune.

DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE

DREJTORISË SË MARRËDHËNIEVE ME PUBLIKUN

AGJENCISË KOMBËTARË TË PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE.

Në zbatim të ligjit nr 15/2019, “Për nxitjen e punësimit” ; të ligjit nr 15/2017 “ Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë, të vendimit të Këshillit të Ministrave nr 554 datë 31.07.2019 “ Për krijimin , mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombetare të punësimit dhe aftësive “ ; të udhëzimit nr 14 datë 27.05.2021 “ Për mënyrën e organizmit dhe veprimtarinë e ofruesve publik të arsimit dhe formimit profesional”.

Ofruesi publik i AFP-së Drejtorisë Rajonale të Ofrimit Formimit Profesional Publik Fier , ju njofton krijimin e vendit të lirë për pozicionin :

- Instruktor/e per kursin Parukeri (Roskovec) 1 person

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë kushte shëndetësorë që e lejojnë të kryejë detyrën
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demostrojë vlera të larta të etikës, sjelljes, dhe komunikimit;
- f) Të demostrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Te kete diplomë të shkolles se mesme profesionale ose kualifikim profesional pas te mesem ne fushen/profesionin e kursit te formimit profesional , per te cilin po aplikon
- b) Te kete te pakten 3(tre)vjet eksperiencë pune në fushën në të cilën është kualifikuar
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit

Dokumentet e aplikimit

1. Dosja e aplikantit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar sipas njoftimit të vendit të lirë , duhet të përfshijë:
 - letërmotivimin për pozicionin;
 - jetëshkrimin (CV-në)

- kartën e indentitetit
- diplomë
- libreza e punës
- çdo dukumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trainimet apo të tjera të përmendura në jetëshkrim;
- çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit;
- vërtetim i gjëndjes shëdetësore
- vërtetimin e gjëndjes gjyqësore
- vërtetim nga punëdhënësi i fundit , që ndaj tij nuk ka masa disiplinore në fuqi;
- rekomandim ose vlerësim pune nga punë dhënës të mëparshëm;
- dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

2. Dokumentet në gjuhën e huaj duhet të jenë të përkthyer në gjuhën shqipe dhe të noterizuara.

3. Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofrimit të AFP-së brenda datës.....17.06.2022

DREJTORI

Aleksander Lalaj

